

3/5

- 45-

INFORMACION

“MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJOR PERROI I LESHICES KOMUNA SURROJ, FSHATI SAKAJ PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA SHOQERIA “ENERGY FINANCE MENAGMENT SHQIPERIA” HIDROCENTRALI LESHNICE NR. 3”.

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nga shoqeria “ ENERGY FINANCE MENAGMENT SHQIPERIA ”, per perdorimin e burimit uJOR perroi i Leshnices per prodhim energjie elektrike nen 15 MW, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin-Bune dhe udhezimit te Perbashket ne mes te M.M.P.AU. me M.E.T.E., rezulton se propozimi i mesiperme nuk ka te beje me projekte per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga kompania e mesiperme vepra e marrjes te ujit, do te ndertohet ne fshatin Sakaj, komuna Surroj, rrethi Kukes, ne kuoten + 459 m. Ndertesa e centralit do ndertohet ne kuoten + 386 m. Prurja mesatare ne vepren e marrjes eshte $Q = 0.27 \text{ m}^3/\text{sek}$. Kompania kerkon te shfrytetoje nje prurje $Q = 1.41 \text{ m}^3/\text{sek}$. tek kjo veper marrje.

Gjate gjithe viti nuk do te pengohet furnizimi me uje i zones.

Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 “ PER KONCESIONET” dhe ne zbatim te tij te germes b, pika 3, kreu IV, i V.K.M. nr. 87 dt. 16.01.2008, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M. “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, per plotesim dokumentacioni.

PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

Sekretari

Muhamet MUÇA

Kryetari

Sekretari Pergjithshem i Prefektures

Fatbardh SHEQI

